



# Sfidat e komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë gjatë Pandemisë Covid - 19



# Sfidat e komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë gjatë Pandemisë Covid - 19

botues:

**ADMOVEERE**

(drejtësi transicionale | edukim | paqëndërtim)

<http://admovere.org/>

ky raport u hartua nga:

**Aulonë Memeti**

**Durim Jasharaj**

hulumtues:

**Aulonë Memeti**

**Durim Jasharaj**

redaktor gjuhësor:

**Gazmend Bërlajolli**

dizajni i kopertinës dhe faqësja:

**Envinion**

shtypi:

**Printing Press**

**korrik 2020**

**Prishtinë**

tirazhi: **300** kopje

hulumtimi dhe botimi u përkrahën nga:

**KFOS (Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur)**

**ADMOVEERE** është anëtare e Koalicionit për Integritet dhe Transparencë në Universitet (KITU), të mbështetur nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS). Ky hulumtim është pjesë e programit të KITU-së. Pikëpamjet e shprehura në këtë hulumtim janë të OJQ-së **ADMOVEERE** dhe nuk paraqesin medoemos pikëpamjet e Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS), të KITU-së, e as të recensentëve.

**ADMOVEERE** (drejtësi transicionale | edukim | paqëndërtim) angazhohet për ndërtimin e një shoqërie demokratike, promovimin e tolerancës e të bashkëjetesës dhe luftimin e paragjytimeve; dialogun mes komuniteteve të ndara për t'i tejkalluar mosmarrëveshjet, si dhe promovimin e praktikave të mira për drejtësi dhe pajtim. Fushat kryesore të organizatës janë të drejtat e njeriut, me theks të veçantë te drejtësia transicionale, edukimi dhe ndërtimi i paqes.

Për më shumë: <http://admovere.org/>



# Përmbajtja

- 06** Shkurtesat
- 07** Falënderimet
- 08** Hyrja
- 10** Gjendja aktuale e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian
- 15** Vendimet e qeverisë për menaxhimin e pandemisë Covid-19
- 18** Vendimet e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës
- 20** Vendimet e Ministrisë së Financave
- 23** Vendimet e Ministrisë së Shëndetësisë
- 26** Agjencia e Punësimit
- 28** Zbatimi i masave kufizuese – Policia e Kosovës
- 31** Masat e komunave për menaxhimin e pandemisë Covid-19
- 32** Komuna e Ferizajt
- 34** Komuna e Lipjanit
- 36** Komuna e Fushë Kosovës
- 38** Menaxhimi i pandemisë sipas njohësve dhe aktivstëve të të drejtave të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian
- 41** Përfundimet
- 45** Fundnotat



# Shkurtesat

APRK	Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës
DA	Drejtoria e Arsimit
DKA	Drejtoritë Komunale të Arsimit
DF	Drejtoria e Financave
DShMS	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
DShPE	Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës
IAL	Institucione të Arsimit të Lartë
IAP	Institucioni i Avokatit të Popullit
KFOS	Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
KITU	Koalicioni për Integritet dhe Transparencë në Universitet
KK	Kuvendi Komunal
MAP	Ministria e Administratës Publike
MASh	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
MF	Ministria e Financave
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MSh	Ministria e Shëndetësisë
PK	Policia e Kosovës
SEMS	Sistemi Elektronik i Menaxhimit të Studentëve
SMIAL	Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsimin e Lartë
SMU	Sistemi i Menaxhimit Universitar
ShBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
ShFMU	Shkolla Filllore e Mesme e Ulët
ShE	Shtabet Emergjente
UA	Udhëzim Administrativ
UP	Universiteti i Prishtinës
USAID	Agjencia e ShBA-së për Zhvillim Ndërkombëtar



# Falënderime

Falënderojmë të gjithë ata që ndihmuan këtë publikim, në radhë të parë përfaqësuesit e Komunës së Ferizajt, Lipjanit dhe Fushë Kosovës. Nga Komuna e Ferizajt falënderojmë z. Bekim Ademi, Drejtor i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe z. Afrim Llabjani, Drejtor i Arsimit; nga Komuna e Lipjanit falënderojmë z. Diamant Bytyqi, Zëdhënës i Komunës, dhe z. Lulzim Qerimi, Nënkyetar për Komunitete; me theks të veçantë falënderojmë z. Ali Topalli, Zëdhënës i Komunës së Fushë Kosovës, për ndihmën e pakursyer gjatë këtij hulumtimi.

Po ashtu, falënderojmë z. Drin Haraçia, Drejtor i Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës, për profesionalizmin e pashoq, si dhe Policinë e Kosovës për

korrektësinë. Në veçanti falënderojmë aktivistët për mbrojtjen dhe të drejtat e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë, z. Bajram Kafu Kinolli, z. Denur Paçaku, z. Driton Berisha, z. Senad Ibishi, z. Gazmend Salijevic, z. Muhamet Arifi dhe z. Osman Osmani për bisedat e frytshme dhe të dhënat e vlefshme lidhur me hulumtimin tonë.

Në fund, falënderojmë Fondacionin e Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS) për mbështetjen financiare për hulumtimin dhe botimin e këtij raporti, Gazmend Bërlajollin për redaktimin gjuhësor, Driton Paçaradën për fotografinë e kopertinës, Envinion për dizajnin e faqosjen, si dhe Printing Press për shtypin e këtij raporti.



# Hyrja

Grupet e marginalizuara, siç janë komuniteti rom, ashkali dhe ai egjiptian, historikisht preken gjithmonë më shumë nga pandemitë dhe katastrofat natyrore. Ndonëse kanë vështirësi në qasjen ndaj shërbimeve të mira shëndetësore, këto komunitete shpeshherë jetojnë në rrethana që e shtojnë probabilitetin ndaj sëmundjeve. Prandaj, është shumë e rëndësishme që të analizohen politikat e nivelit qendror dhe të atij lokal për adresimin e nevojave të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në kohë krizash.

Qëllimi i parë i këtij publikimi është t'i identifikojë dhe t'i shqyrtojë masat e ndërmarra nga Qeveria e Republikës së Kosovës, me theks te komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian, për parandalimin dhe menaxhimin e pandemisë Covid-19. Për këtë arsye analizuaam të gjitha vendimet e Ministrisë së Shëndetësisë (MSh), Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (MASH), si dhe Ministrisë së Financave (MF). Për më tej, kërkuam qasje në dokumente dhe të dhëna publike nga MSh, MASH dhe MF, përcollëm raportimet e mediave dhe të portaleve kryesore në lidhje me pandeminë, si dhe zhvilluam intervistë me Drejtorin e Agjencisë së Punësimit të Kosovës (APRK). Kufizimi kryesor i kësaj pjese të hulumtimit është mospërgjigjia e ministrive në kërkesat tona.

Qëllimi i dytë i këtij hulumtimi është t'i identifikojë dhe t'i shqyrtojë masat e ndërmarra nga Komuna e Ferizajt, Lipjanit dhe Fushë

Kosovës, me theks te komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian, për menaxhimin dhe zbutjen e pasojave të pandemisë Covid-19. Për këtë arsye analizuaam të gjitha vendimet e këtyre tri komunave në lidhje me pandeminë, si dhe bëmë një përmbledhje të të gjitha lajmeve dhe njoftimeve të publikuara në faqet e tyre zyrtare. Po ashtu, zhvilluam intervista me shefat dhe koordinatorët e shtabeve emergjente komunale, me nënkryetarët dhe zëdhënësit e komunave, si dhe me drejtorët e arsimit, të shëndetësisë dhe të mirëqenies sociale.

Qëllimi i tretë i këtij hulumtimi është të shqyrtojë zbatimin dhe ndikimin e këtyre masave te komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian. Për këtë arsye kërkuam nga Agjencia e Punësimit të dhëna për numrin e të papunëve të regjistruar në shkallë vendi për periudhën mars-qershor, e në veçanti për muajin prill; numrin e përfituesve të masës së pestë të pakos emergjente fiskale; numrin e familjeve përfituese të asistencës sociale, etj. Përmbledhëm edhe lajmet dhe artikujt e portaleve në lidhje me gjendjen e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian gjatë pandemisë. Veç këtyre, intervistuaam përfaqësuesit e komunës së Ferizajt, Lipjanit dhe Fushë Kosovës në lidhje me masat afirmative të ndërmarra gjatë kësaj periudhe dhe zhvilluam diskutime me përfaqësues të organizatave që angazhohen për të drejtat e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian.





# Gjendja Aktuale e Komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian

Për të theksuar rëndësinë e masave afirmative në raste krizash për komunitetet e marginalizuara, siç janë komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian, identifikuar problemet kryesore me të cilat këto komunitete ballafaqohen që nga paslufta e deri në qershor 2020, në disa fusha prioritare, të adresuara edhe në strategjinë e Qeverisë së Kosovës për përfshirjen e komunitetit rom në shoqërinë kosovare (2017-2021): arsimi, punësimi, mirëqenia sociale, shëndetësia dhe strehimi. Për këtë shqyrtoam dokumente të ndryshme dhe strategji të hartuara nga institucionet e Kosovës, pastaj ligje të miratuara nga Kuvendi i Kosovës, raporte të progresit të Komisionit Evropian (KE) që nga viti 2005 e deri më 2019, e sidomos raporte, analiza dhe studime të OJQ-ve të ndryshme vendore e ndërkombëtare.

## Arsimi

Qysh fill pas luftës (1999) komunitetet minoritare, e sidomos romët, ballafaqohen me diskriminim në qasjen për edukim. Deri në shpalljen e Pavarësisë më 2008, vijimi i procesit mësimor nga nxënësit e komunitetit rom në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar ka qenë shumë i

ulët, sidomos për vajzat. Pas shpalljes së Pavarësisë, shkalla e përfshirjes së romëve në të gjitha nivelet e arsimit shënoi rritje, mes tjerash edhe falë angazhimit të organizatave vendore e ndërkombëtare, qeveritare e joqeveritare. Këtu vlen të përmenden Qendrat Mësimore nëpër komunat ku ka romë, të cilat tanimë janë formalizuar përmes akteve nënligjore nga MASH-i, por edhe ndarja nga MASH-i e rreth 600 bursave me nga 300 euro në vit për nxënësit romë.<sup>1</sup> Megjithëkëtë, numri i nxënësve romë të regjistruar në shkolla mbetet i pakënaqshëm, ka braktisje të mëdha të shkollës, sidomos nga vajzat, dhe nivel tejet të ulët të mësimnxënies.

Shkalla e shkrim-leximit të komunitetet romë, ashkalinj dhe egjiptianë është më e ulët krahasuar me pjesën tjetër të popullsisë. Nga rreth 98% e popullsisë së Kosovës që di shkrim-lexim, vetëm 73% e grave dhe rreth 87% e burrave romë, ashkalinj dhe egjiptianë dinë shkrim-lexim.<sup>2</sup> Në shkallë vendi, pjesëmarrja e rinisë romë, ashkalie dhe egjiptiane, nga 65% në shkollën e mesme të ulët bie në 30% në shkollën e mesme të lartë.<sup>3</sup>

Në nivelin e arsimit të lartë, pavarësisht se universitetet publike në Kosovë kanë kuota të caktuara për regjistrimin e studentëve romë, numri i tyre vazhdon me qenë i vogël. Sipas përfaqësuesve të Roma Versitas, 42 studentë nga të tri komunitetet u regjistruan në institucionet e arsimit të lartë në vitin akademik 2018-2019, ndërsa kjo shifër u rrit në 53 në vitin akademik 2019-2020.<sup>4</sup>

Komunitetet romë, ashkalinj dhe egjiptianë ballafaqohen me këto probleme arsimimi për shkak të: kushteve të rënda socio-ekonomike, nivelit të lartë të papunësisë, nivelit të ulët të edukimit tek prindërit romë mbi rëndësinë e shkollimit të fëmijëve të tyre, mungesës së mësuesve të kualifikuar nga radhët e këtyre komuniteteve, suksesit të dobët të nxënësve në mësim (përsëritje të vitit), diskriminimit, paragjyqimeve, abuzimit verbal e fizik (bullizmit) nga nxënësit dhe arsimtarët shqiptarë nëpër shkolla, martesave të hershme, qasjes së kufizuar në infrastrukturë përkatëse deri në shkollë (rrugë, ndriçim, transport), migrimit të familjeve për arsye ekonomike dhe kthimit prapa në Kosovë. Ka edhe raste kur fëmijët romë që flasin sërbi nuk ndjekin mësimin në shkollat sërbe nga frika e problemeve me shqiptarë, e kështu me radhë.

### **Punësimi**

Me transformimin e ekonomisë nga e centralizuar në të tregut, pra me privatizimin e ndërmarrjeve publike, shumë romë janë pushuar nga vendet e punës. Në përgjithësi, pjesëtarët e këtij komuniteti, larg më shumë sesa ata të komuniteteve të tjera, punojnë në sektorin joformal, madje në vende pune

të rrezikshme, të pasigurta, të përkohshme, me gjysmë orari, me status të ulët (kryesisht punë fizike që nuk kërkojnë shkathhtësi të larta) e me paga të vogla, ndërkohë që edhe fëmijët romë vazhdojnë të jenë të zënë me punë. Prandaj, shkalla e varfërisë te ky komunitet, e krahasuar në nivel kombëtar e individual për të ardhurat për kokë banori me komunitetet e tjera, është shumë e lartë dhe me tendencë të vazhdueshme të rritjes.

Sa i takon punësimin të pjesëtarëve të minoriteteve etnike në sektorin publik, Ligji për Shërbimin Civil në Kosovë parasheh kuotë minimale prej 10% në nivelin qendror, ndërsa në atë lokal përfaqësim proporcional sipas përbërjes demografike.<sup>5</sup> Mirëpo, institucionet e Kosovës nuk ia kanë dalë, as në nivel lokal e as në atë qendror, që të kenë përfaqësim të drejtë e proporcional të komunitetit rom në shërbimin civil.

Vështirësinë kryesore të pjesëtarëve të komunitetit rom për punësim e krijojnë niveli përgjithësisht i ulët i punësimin në Kosovë, mungesa e kualifikimeve për shkak të mosshkollimit, diskriminimi, shpërfillja, përjashtimi dhe korrupsioni, mungesa e lidhjeve me familjarë e miq të punësuar e të angazhuar nëpër parti politike, etj. Për më shumë, qasja e tyre në shërbimet e punësimin dhe të trajnimit profesional, të siguruar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) dhe organizatat e tjera, është e kufizuar për shkak se u mungon informacioni i mjaftueshëm për zyrat e punësimin dhe qendrat e aftësimin profesional.

Hendeku mes shkallës së punësimit te komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian dhe te komunitetet e tjera që jetojnë në afërsi, është shumë i madh. Papunësia tek të rinjtë është shumë e lartë: 78% e romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve të moshës 18-24 vjeçare as nuk kanë vend pune, as nuk janë të përfshirë në arsim.<sup>6</sup>

### **Mirëqenia**

Gati gjysma e romëve në Kosovë deri vonë nuk kanë qenë të regjistruar si banorë të Kosovës, gjë që i ka penguar të përfitojnë nga shërbimet administrative dhe sociale. Vendbanimet joformale të tyre mbeten problem dhe kushtet e jetesës janë jashtëzakonisht të pasigurta. Banorët e disa kampeve për të zhvendosurit kanë pësuar kontaminim të ndjeshëm prej plumbit, veçanërisht në veri të vendit.

MPMS ka ndërmjetësuar në punësimin e 524 punëkërkesve nga të gjitha komunitetet minoritare, duke përfshirë komunitetin rom, si masë për të ndikuar pozitivisht në tregun e punës. Ende mungojnë veprime adekuate për të trajtuar përfshirjen sociale të grupeve të veçanta, përfshirë edhe të kthyerit romë.<sup>7</sup>

Më 2018, krahasuar me familjet jorome, 29% më shumë prej familjeve rome kishin nga një person që shkonte në shtrat i uritur. Krahasuar me familjet jorome në afërsi të tyre, familjet rome kanë 17% më pak qasje në banjë nëpër banesat e tyre; 10% më pak përdorin shërbimet shëndetësore parandaluese; 23% më pak të rinj janë të përfshirë në punësim, arsim ose trajnim.<sup>8</sup>

Qasja në shërbimet e punësimit dhe

në trajnimin profesional, të siguruara nga MPMS-ja dhe organizata të tjera, është e kufizuar për shkak të mungesës së informacionit. Duhet shtuar përpjekjet për të parandaluar punën e fëmijëve dhe martesën e fëmijëve, e cila i prek në veçanti vajzat. Disa njerëz ende përballen me vështirësi të dokumentacionit civil, shpesh të lidhur me kthimin ose riatdhesimin.

### **Përkujdesi shëndetësor**

Kushtet e jetesës në disa vendbanime kanë qenë shumë shqetësuese, sidomos kampet e kontaminuara nga plumbi, ngase kanë përbërë rrezik serioz për shëndetin e banorëve. Shërbimet shëndetësore nuk ofrohen në mënyrë adekuate te komunitetet pakicë, e sidomos tek romët. Ministria e Shëndetësisë ka miratuar një protokoll të shqyrtimit dhe trajtimit të të kontaminuarve prej plumbit. Nivelet e kontaminimit me plumb në rajonin e Mitrovicës mbeten të larta. Mbulimi me vaksinim te komuniteti rom është më i ulët se te komunitetet e tjera. Nga janari i vitit 2011, Instituti për Shëndetësi Publike realizoi një fushatë vaksinimi të fëmijëve romë kundër sëmundjeve të ndryshme.

Fëmijët romë të kontaminuar me plumb vazhdojnë të marrin mbështetje mjekësore. Megjithatë, burimet e pamjaftueshme financiare pengojnë zbatimin e politikave të përgjithshme ligjore lidhur me shëndetin.

Qasja në shëndetin publik është falas, por mbulon vetëm nevojat themelore. Me vetëm tre në dhjetë fëmijë romë të imunizuar plotësisht, shkalla e mbulimit me imunizim

të komunitetit mbetet shqetësuese. Mungesa e informacionit rreth shërbimeve të ofruara nga institucionet publike dhe rastet e diskriminimit e pengojnë aksesin në shërbimet shëndetësore.

### **Strehimi**

Strehimi i romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve mbetet çështje e vështirë. Shumica e pjesëtarëve të këtyre komuniteteve jetojnë në vendbanime joformale. Nevojat e tyre për strehim janë përmbushur kryesisht prej donatorëve ndërkombëtarë. Në vitin 2018 qeveria ndau 2,4 milion euro për ndërtimin e banesave sociale për komunitetin rom, ashkali dhe komunitetet e tjera të marginalizuara.

Familjet e këtyre tri komuniteteve jetojnë kryesisht nëpër shtëpi ose banesa që i kanë në pronësi, por që janë në kushte të mjera, në radhë të parë për shkak të paqëndrueshmërisë ndërtimore. Ambientet nëpër këto shtëpi/banesa janë tejet të ngushta në përpjestim me numrin e familjarëve, pa banjo që të përmbushin kushtet minimale higjieno-sanitare dhe pa pajisje themelore shtëpiake: shporet elektrik, frigorifer, bojler, termo-akumulues, rrobararëse, fshesë elektrike. Strehimi i këtyre komuniteteve është ndërlikuar edhe nga shkatërrimi i pronave të tyre gjatë e pas luftës, uzurpimi i pronave pas luftës, mungesa e dokumentacionit për blerjen e pronave prej serbëve që u larguan nga Kosova, etj.

**Më 2018, krahasuar me familjet jorome, 29% më shumë prej familjeve rrome kishin nga një person që shkonte në shtrat i uritur. Krahasuar me familjet jorome në afërsi të tyre, familjet rrome kanë 17% më pak qasje në banjë nëpër banesat e tyre; 10% më pak përdorin shërbimet shëndetësore parandaluese; 23% më pak të rinj janë të përfshirë në punësim, arsim ose trajnim.**



# **Vendimet e Qeverisë për Menaxhimin e Pandemisë Covid-19**

# Hyrje

Qëllimi i parë i këtij publikimi është që t'i identifikojë dhe t'i shqyrtojë masat e ndërmarra nga Qeveria e Republikës së Kosovës, me theks te komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian, për parandalimin dhe menaxhimin e pandemisë Covid-19. Analizuar të gjitha vendimet e qeverisë dhe të ministrive përkatëse: të Ministrisë së Shëndetësisë (MSh), të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASH), si dhe të Ministrisë së Financave dhe Transfereve (MF).

Rezulton se vendimi i parë nga mbledhja e parë e qeverisë në lidhje me pandeminë është i datës 28 shkurt 2020. Kërkuam edhe qasje në dokumente publike në këtyre tri ministrive, por vetëm MSh na ofroi të dhënat e kërkuara, kurse MASH dhe MF nuk iu përgjigjën kërkesës sonë. Në vazhdim po i paraqitesim të gjitha vendimet dhe masat e ndërmarra nga qeveria, të cilat figurojnë në faqet zyrtare të ministrive përkatëse.



# Vendimet e Qeverisë për Menaxhimin e Pandemisë Covid-19

Deri më 1 qershor 2020, në faqen zyrtare të Qeverisë së Republikës së Kosovës janë publikuar gjithsej 27 vendime që kanë të bëjnë me parandalimin dhe menaxhimin e pandemisë Covid-19. Këto janë vendime nga mbledhjet e Qeverisë, dhe në to nuk përfshihen të gjitha masat dhe vendimet e Qeverisë për menaxhimin e situatës pandemike, meqë shumë të tjera janë marrë në nivelin e ministrive përkatëse. Vendimet e ministrive trajtohen në kapituj të veçantë. Në të gjitha vendimet dhe masat e analizuara të Qeverisë dhe të ministrive mungon kujdesi për komunitetet romë, ashkalinj dhe egjiptianë. Me përjashtim të masës së nëntë nga Pakoja Emergjente Fiskale, që parasheh financimin e projekteve për këto komunitete me vlerë deri në 2 milion euro, nuk ka ndonjë masë tjetër afirmative.

1. Vendimi i parë i Qeverisë së Kosovës lidhur me parandalimin e pandemisë Covid-19 është marrë me 28 shkurt 2020. Sipas këtij vendimi, Ministrisë së Shëndetësisë i ndahen 400.000 euro për parandalimin e situatave të mundshme emergjente.<sup>9</sup>
2. Më 10 mars 2020 miratohet kërkesa e MSh për aprovimin e planit për gatishmëri dhe planit të veprimit për parandalimin e pandemisë Covid-19.<sup>10</sup>
3. Më 11 mars 2020 miratohet kërkesa e MSh për ndërmarrjen e 11 masave me qëllim të parandalimit të pandemisë Covid-19. Ndër to spikasin: ndërprerja e procesit edukativo-arsimor; pezullimi i përkoshëm i linjave të udhëtimit ajror dhe tokësor nga vendet me rrezikshmëri të lartë dhe të mesme; vetëkarantimi për të gjithë që hyjnë në Kosovë nga vendet me rrezikshmëri të lartë dhe të mesme; ndalimi i punës pas orës 23.00 për restorantet, kafenetë, klubet e natës, pishinat.<sup>11</sup>
4. Më 13 mars 2020 merren 13 masa, pas konfirmimit të rasteve të para me Covid-19. Ndalohet transporti urban dhe ndërurban, kurse më 16 mars ndalohen të gjitha linjat ajrore, përveç atyre ushtarake dhe të urgjencave.<sup>12</sup>

5. Më 18 mars 2020, Qendra e Studentëve caktohet si hapësirë karantinimi dhe menaxhohet nga MSh deri në pushimin e gjendjes emergjente të shpallur nga Qeveria e Kosovës.<sup>13</sup>
6. Më 23 mars 2020 Qeveria miraton propozimin e MSh për ndërmarrjen e masave shtesë për parandalimin e Covid-19. Ndalohet qarkullimi i qytetarëve dhe i automjeteve që nga 24 marsi, gjatë orarit 10.00-16.00 dhe 20.00 – 06.00. Ndalohet edhe qarkullimi i më shumë se dy personave së bashku.<sup>14</sup>
7. Më 26 mars 2020 vazhdohet ndërprerja e procesit arsimor në institucionet publike dhe private të arsimit, në të gjitha nivelet.<sup>15</sup>
8. Më 30 mars 2020 aprovohet Pakoja Emergjente Fiskale, ku parashihen 15 masa që kapin vlerën e mbi 170 milionë eurove. Përmes kësaj pakoje u synua adresimi i problemeve ekonomike të shkaktuara nga pandemia, përfshirë veprimet dhe intervenimet që kanë për synim ndihmën për qytetarët në ato role e funksione që ua ka dëmtuar pandemia (si përfitues të skemave sociale nga shteti, konsumatorë, punëmarrës, qiramarrës ose punëdhënës).<sup>16</sup>
9. Më 8 prill 2020, MSh autorizohet për të përcaktuar orarin e ri të lëvizjes për secilën komunë.<sup>17</sup>
10. Më 23 prill 2020 aprovohet kërkesa e Ministrisë së Shëndetësisë për transferimin e mjeteve në vlerë prej 820 mijë euro.<sup>18</sup>
11. Më 27 maj 2020 mbyllet Qendra e Studentëve dhe qendra për të huajt në Vranidoll si hapësira karantinimi. Merret vendim që të gjithë personat që hyjnë në Kosovë të vetizolohen për 14 ditë.<sup>19</sup>
12. Më 31 maj 2020 merret vendim për të kaluar në fazën e lehtësimit të masave. Ndër to spikasin: rihapja e kopshteve për fëmijë, publike e private; përgatitja e testit të arritshmërisë me klasat e nënta; organizimi i testit të maturës për klasat e dymbëdhjeta; mbajtja e provimeve nga institucionet e arsimit të lartë; hapja e kufijve tokësorë; hapja e bareve, restoranteve, qendrave tregtare dhe kafeterive.<sup>20</sup>

---

**Nga gjithsej 27 vendime të Qeverisë së Kosovës për menaxhimin e pandemisë Covid-19, vetëm njëri vendim lidhet me komunitetet romë, ashkalinj dhe egjiptianë.**





# Vendimet e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës gjatë Periudhës së Pandemisë Covid-19

Më 11 mars 2020, në mbledhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me propozimin e Ministrisë së Shëndetësisë, u vendos të ndërpritej procesi edukativo-arsimor në të gjitha nivelet e arsimit publik dhe privat. Si pasojë e rrethanave të krijuara nga pandemia Covid-19, MASH filloi organizimin e procesit mësimor nga distanca. Për nevojat e këtij hulumtimi, shqyrtuam të gjitha vendimet që lidhen me procesin edukativo-arsimor gjatë periudhës së pandemisë, nga 12 marsi deri më 1 qershor 2020.

Në faqen zyrtare të MASH, te rubrika e publikimeve figurojnë të gjitha udhëzimet dhe dokumentet që kanë të bëjnë me mësimin në distancë dhe masat e ndërmarrë. Te rubrika e-mësimi, përveç këtyre dokumenteve, mundësohet edhe lidhja me kanalën zyrtar të MASH në Youtube, ku gjenden mësimet dhe ligjëratat për klasat 1-9.

Në faqen zyrtare të Ministrisë janë publikuar gjithsej gjashtë udhëzime, tetë orare mësimi online si dhe një dokument shpjegues mbi përdorimin e platformës Zoom. Mirëpo, në asnjërin nga dokumentet nuk ka ndonjë masë specifike të ndërmarrë për komunitetin rom, ashkali dhe egjiptian. Për më shumë, vetëm dy nga këto dokumente, *Udhëzimi për vlerësimin e nxënësve gjatë mësimin në distancë* dhe *Vendimi për detyrat dhe përgjegjësitë për realizimin e mësimin në distancë*, janë të përkthyer edhe në serbisht e turqisht.

## Vendime

1. Vendimi për detyrat dhe përgjegjësitë për realizimin e mësimin në distancë për klasat 1-12, është marrë më 30 mars 2020. Përmes tij përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë e DKA-ve, drejtorëve të shkollave, kujdestarëve, mësimdhënësve, prindërve dhe nxënësve. Mësimi realizohet online

- përmes platformave të ndryshme sociale, siç janë Meet, Zoom e Google Classroom.<sup>21</sup>
2. Udhëzimi për Drejtoritë Komunale të Arsimit për realizimin e mësimit online për shkollat e mesme të larta, shkollat e mesme të larta profesionale dhe qendrat e kompetencës, është marrë më 30 mars 2020. Ky udhëzim rregullon procesin mësimor në distancë për nivelin e mesëm të lartë, për gjimnaze dhe shkolla profesionale.<sup>22</sup>
  3. Udhëzimi për realizimin e mësimit në distancë për nxënësit me nevoja të veçanta është marrë më 14 prill 2020. Divizioni për Arsim Gjithëpërfshirës në kuadër të MASH u ngarkua për bashkërendimin e mësimit në distancë, në bashkëpunim me DKA-të dhe Qendrat Burimore. Këto të fundit janë institucione të specializuara për ofrimin e mbështetjes profesionale për nxënësit me nevoja të veçanta.<sup>23</sup>
  4. Udhëzimi për vlerësimin e nxënësve të arsimit parauniversitar gjatë mbajtjes së mësimit në distancë është marrë më 24 prill 2020.<sup>24</sup>
  5. Udhëzuesi për provimin e maturës shtetërore 2020 është marrë më 28 maj 2020. Provimi i Maturës Shtetërore do të mbahet më 4 korrik 2020, dhe atij do t'i nënshtrohen të gjithë kandidatët që i plotësojnë kushtet e përcaktuara me Ligjin për Provimin e Maturës Shtetërore.<sup>25</sup>

#### **Mbarëvajtja e procesit mësimor në UP**

Sa i përket arsimit të lartë, studimet nga distanca UP i ka filluar më 16 mars 2020. Nga faqja zyrtare e Universitetit shohim se në periudhën 16 mars - 1 qershor 2020, pjesëmarrja e studentëve në ligjërata është e ulët. Në UP, studimet i vijnë gjithsej 72 studentë të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian. Mësimin online e kanë ndjekur 61 studentë të këtyre komuniteteve.<sup>26</sup>



# Vendimet e Ministrisë së Financave gjatë Periudhës së Pandemisë Covid-19

Rubrika Masat Ekonomike-Financiare për Covid-19 në faqen zyrtare të MF-së ndahet në katër nënrubrika: dokumente dhe vendime, masat, pyetjet e shpeshta dhe formularët për aplikim. Për nevojat e këtij hulumtimi, shqyrtuam të gjitha vendimet dhe masat e publikuara në faqen zyrtare të MF-së që lidhen me parandalimin dhe menaxhimin e Covid-19.

## Dokumente dhe vendime

1. Më 16 prill 2020 është marrë vendimi për operacionalizimin e masës 15 nga Pakoja Emergjente Fiskale. Masa 15 parasheh asistencën mujore në vlerë prej 130 eurosh për periudhën prill-qershor 2020. Përfituesit e saj janë familjet pa asnjë familjar të punësuar në sektorin publik a privat, njëkohësisht të regjistruar si të papunë në institucionet kompetente.<sup>27</sup>
2. Njoftimi për punëtorët e dyqaneve ushqimore u nxor me 20 prill 2020. Ai specifikon mënyrën e aplikimit të masës së shtatë (shtesën prej 100

eurosh për punëtorët e dyqaneve ushqimore, të furrave dhe të barnatoreve) nga Pakoja Emergjente Fiskale.<sup>28</sup>

Plani Operacional për Pakon Fiskale Emergjente hyri në fuqi më 27 prill 2020 dhe përfshin gjithsej 15 masa:<sup>29</sup>

**Masa 1:** Pagesa e dyfishtë për të gjithë përfituesit e skemës sociale (prill-maj 2020), ku përfshihet edhe pagesa për muajin mars.

**Masa 2:** Shtesa në vlerë prej 30 eurosh (prill-maj 2020) për të gjithë përfituesit e skemave sociale dhe pensionale që marrin pagë mujore më të ulët se 100 euro, me kusht që të jenë përfitues të vetëm një skeme.

**Masa 3:** Mbështetje financiare për shoqëritë tregtare (shoqëria tregtare interpretohet në kuptim të gjerë; përfshihen të gjithë punëdhënësit):

- a. Mbulimi i shpenzimeve të pagës mujore të punonjësve në vlerë prej 170 eurosh për muajt prill-maj 2020. Përfitues të kësaj mase janë të gjitha ato shoqëri tregtare që si pasojë e situatës emergjente dhe për shkak të vendimeve të Qeverisë janë detyruar ta ndërpresin punën.

I punësuari mund të përfitojë nëse ka qenë në listën e pagave për muajin shkurt 2020.

- b. Subvencionim i qirasë për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme deri në 50% të vlerës së qirasë për muajt prill e maj 2020.
- c. Mbulimi i vlerës së kontributeve pensionale për pagat lidhur me masat e ndërmarra për prill-maj 2020.

**Masa 4:** Sigurimi i huadhënies pa interes për ndërmarrjet publike që kanë vështirësi si rezultat i gjendjes së krijuar, deri më 31 dhjetor 2020.

**Masa 5:** Mbështetje financiare për Komunitet në vlerë deri 10 milion euro. Prioritet kanë komunitet të më të prekuara nga pandemia.

**Masa 6:** Shtesa mbi pagë mujore (prill-maj 2020), në vlerë prej 300 eurosh për punëtorët në terren që i ekspozohen drejtpërdrejt rrezikut për infektim. Këtu përfshihen: stafi mjekësor (mjekët dhe infermierët), policët, gardianët,

zjarrfikësit, personeli i FSK-së, punëtorët që punojnë në kohë karantine, punëtorët në Qendrën e Studentëve, inspektorët e punës, zyrtarët e administratës tatimore, doganierët, inspektorët e tregut, zyrtarët e inspektorateve përkatëse komunale, të inspektorateve të mjekësisë së punës.

**Masa 7:** Shtesë nga 100 euro në muaj (prill-maj 2020), për punëtorët e dyqaneve ushqimore, të furrave dhe të barnatoreve.

**Masa 8:** Asistencë mujore prej 130 eurosh (prill-qershor 2020), për qytetarët që kanë humbur vendin e punës si rezultat i pandemisë.

**Masa 9:** Mbështetje e iniciativave dhe e projekteve që kanë synim përmirësimin e jetës së komuniteteve joshumicë të goditura rëndë nga Covid-19. Kjo masë do të realizohet nga Zyra e Kryeministrit, përkatësisht Zyra për Komunitete, në konsultim me Komunitet dhe Kryeqin e Kuq. Në fokusin e kësaj mase janë komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian.

**Masa 10:** Sigurimi i likuiditetit financiar për mikrondërmarrjet dhe të vetëpunësuarit deri në 10 mijë euro, për një periudhë 24-muajshe.

**Masa 11:** Rritja e buxhetit për grante dhe subvencione për Ministrinë e Bujqësisë.

**Masa 12:** Rritja e buxhetit për grante dhe subvencione për Ministrinë e Kulturës.

**Masa 13:** Mbështetje për eksportuesit pas përfundimit të situatës emergjente.

**Masa 14:** Mbështetje financiare për shoqëri tregtare që regjistrojnë punonjës me kontratë pune së paku njëvjeçare gjatë periudhës së emergjencës. Kjo ndihmë është në vlerë prej 130 eurosh në muaj për dy muaj pas datës së regjistrimit.

**Masa 15:** Pagesë e asistencës sociale (prill-qershor 2020) në vlerë prej 130 eurosh në muaj për qytetarët me kushte të rënda sociale.

### **Masat**

1. Udhëzuesi i përkohshëm për aplikimin e masave për parandalimin dhe luftimin e Covid-19 në institucione publike dhe private u nxor më 5 maj 2020.

Sipas tij, institucionet publike dhe private duhet të zhvillojnë protokolle të veçanta për zbatimin e masave për parandalimin dhe luftimin e përhapjes së Covid-19 në vendet e punës.<sup>30</sup>

2. Më 4 maj 2020 u mor vendimi për hyrjen në fazën e parë të lirimit të masave, ku përfshihen: liria e lëvizjes për qytetarët (tri orë në ditë), rifillimi i punës në sektorin e ndërtimtarisë dhe të patundshmërisë, tregtia e automjeteve (pjesërisht), tregtia me pakicë (pjesërisht), riparimi i artikujve dhe i orendive, si dhe zyrat e stafit të konsulencës (me lista të stafit esencial).<sup>31</sup>



# Vendimet e Ministrisë së Shëndetësisë gjatë Periudhës së Pandemisë Covid-19

Të gjitha vendimet dhe masat e Ministrisë së Shëndetësisë (MSh) për menaxhimin dhe parandalimin e pandemisë Covid-19 janë të publikuara në rubrikën “Njoftime rreth Coronavirusit” të faqes së saj zyrtare në internet. Në rubrikë figuron vetëm një vendim që lidhet me pandeminë, ndërsa pjesa tjetër përfshin komunikatat e lëshuara nga MSh që nga fillimi i pandemisë si dhe një dokument me oraret e barnatoreve kujdestare. Për nevojat e hulumtimit i shqyrtuam edhe lajmet e faqes zyrtare të MSh.

Deri më 1 qershor 2020, numri i të testuarve për Covid-19 në Republikën e Kosovës është 14.968, numri i të vdekurve 30, i të shëruarve 873 dhe i rasteve aktive 210. As Ministria e Shëndetësisë as IKShP nuk kanë ndonjë të dhënë mbi numrin e të testuarve, të shëruarve, të vdekurve a të rasteve aktive nga komuniteti rom, ashkali e egjiptian. Për Komunën e Fushë Kosovës, Lipjanit dhe Ferizajt, përgjigjet e të dyja

institucioneve ishin të njëjta: nuk kishin asnjë të dhënë.

Më 23 mars 2020 Qeveria miratoi propozimin e MSh-së për të ndërmarrë masa shtesë për parandalimin e Covid-19. Nga 24 marsi u ndalua qarkullimi i qytetarëve dhe i automjeteve gjatë orareve 10.00-16.00 dhe 20.00-06.00. U ndalua edhe qarkullimi i më shumë se dy personave së bashku. Mirëpo, më 31 mars 2020 Gjykata Kushtetuese konstatoi se kufizimi i të drejtave dhe i lirive themelore mund të bëhet vetëm me ligj të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Megjithatë, për shkak të situatës emergjente, u tha se vendimi do të hynte në fuqi më 13 prill 2020.<sup>32</sup>

Më 15 prill 2020 hyri në fuqi vendimi për parandalimin dhe eliminimin e sëmundjes ngjithëse Covid-19 në territorin e komunave të Kosovës. Përmes vendimeve të veçanta hynë në fuqi masat e reja të qarkullimit

për komunat e Kosovës. Këto masa vlenin deri më 4 maj 2020. Në vendime u parapanë edhe sanksionet financiare për kundërvajtje administrative për personat fizikë dhe ata juridikë.<sup>33</sup>

**Përmbledhje Ekzekutive - Korniza e menaxhimit social dhe mjedisor për reagimin ndaj Covid-19 të Projektit të Shëndetësisë në Kosovë.**<sup>34</sup> Qeveria e Kosovës i ka dërguar një letër Bankës Botërore më 24 mars 2020, duke kërkuar shtyrjen e datës së mbylljes së Projektit ekzistues të Shëndetësisë në Kosovë (PShK), dhe rialokimin e 3.7 milionë eurove që do të përdroreshin për nevojat emergjente për Covid-19. PShK-së do t'i shtohet komponenta e re nr. 4 për t'i adresuar nevojat e vendit për reagim emergjent ndaj shpërthimit të Covid-19, për t'i siguruar furnizimet e nevojshme mjekësore, shtretërit, për riorganizimin e institucioneve shëndetësore, për zonat e testimit dhe të karantinës.

### Lajmet

MSh pranoi nga UNICEF-i 3.6 tonelata të mjeteve mbrojtëse për personelin shëndetësor:

- 36.200 dorëza,
- 33.600 maska kirurgjike,
- 2.700 maska me mbushje të dendur,
- 1.000 kominoshe për mbrojtje,
- 8.960 mantele,
- 2.800 përparëse mbrojtëse.

Zyra e UNICEF-it në Kosovë ka lidhur partneritet me Kryqin e Kuq të Kosovës dhe

autoritetet komunale për shpërndarjen e 12.000 pakove të higjienës familjare për familjet më në nevojë. Pakot ushqimore dhe higjienike janë shpërndarë gjithashtu edhe për komunitetet romë, ashkalinj dhe egjiptianë, si dhe për komunat e banuara nga komuniteti serb në Kosovë.

Më 8 prill 2020, në Prishtinë ka mbërritur kontigjenti i parë i mjeteve mbrojtëse profesionale dhe pajisjeve mjekësore nga Turqia. Ai përmban maska mbrojtëse, dorëza, veshje për personelin shëndetësor, teste dhe pajisje si respiratorë, defibrilatorë, puls-oksimetër, etj., të cilat do t'i shërbejnë personelit shëndetësor për t'u ballafaquar me Covid-19.

Më 13 mars 2020, Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, deklaroi në konferencë për media se janë konfirmuar edhe 79 raste të reja me Covid-19. Kjo është dita me numrin më të madh të rasteve që nga fillimi i pandemisë deri më 1 qershor 2020.

Më 23 prill 2020 mbërriti në Prishtinë dërgesa e tretë e UNICEF-it me materiale mjekësore. Ajo përmbante 8.960 mantele kirurgjike, 2.680 maska FFP2/N95 dhe 33.600 maska kirurgjike si ndihmë nga Qeveria e Luksemburgut. Deri në këtë datë UNICEF-i ka ofruar 36.200 dorëza, 68.544 maska kirurgjike, 5.380 maska FFP2/N95, 1.000 kominoshe për mbrojtje, 51.460 mantele kirurgjike dhe 2.934 përparëse mbrojtëse, 81 termometra klinikë me rreze infra të kuqe, të gjitha këto në mbështetje të reagimit ndaj pandemisë për të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë.

Më 30 prill 2020, Ministri Arben Vitia shpalli vendimin për lirim të masave.

Faza e parë filloi më 4 maj me planifikimin që të vazhdonte deri më 18 maj. Gjatë kësaj periudhe u zgjat orari i lirisë së lëvizjes nga 1.5 në 3 orë gjithsej, me nga dy orare, paradite dhe pasdite. U hapën këto pjesë të ekonomisë: ndërtimtaria dhe patundshmëria; tregtia e automjeteve (pjesërisht); tregtia me pakicë (pjesërisht); riparimi i artikujve personalë dhe i orendive; zyrat e konsulencës (me lista të stafit esencial).

Faza e dytë filloi më 18 maj dhe vazhdoi deri më 1 qershor. Në kuadër të saj u përfshinë lejimi i qarkullimit të qytetarëve në bazë të situatës epidemiologjike, tregtia me pakicë (plotësisht), flokëtarët dhe sallonet e ondulimit, fizioterapeutët dhe dentistët, tregu i gjelbër, transporti hekurudhor, transporti urban dhe ndërrurban (me leje të veçanta), qendrat e thirrjeve (stafi esencial) si dhe hapja e

muzeve dhe e galerive. U mor vendimi për lejimin e veprimtarisë të stomatologëve<sup>35</sup> dhe vendimi për lejimin e veprimtarisë së fizioterapeutëve,<sup>36</sup> duke respektuar Udhëzuesin e Përkoshëm. U lejua vazhdimi i procesit stërvitor të ekipeve të superligës së Federatës së Futbollit të Kosovës<sup>37</sup>. Federata e Futbollit u udhëzua të zbatonte Udhëzuesin e Përkoshëm gjatë zhvillimit të pjesës së mbetur të kampionatit.

Më 28 maj 2020, MSh shpalli masat e reja. Për secilën komunë u vendos orari i ri i lëvizjes për personat fizikë. U ndalua qarkullimi prej orës 21.00 deri në 05.00. Vendimet e fazës së tretë për lirim të masave janë këto: qarkullimi i qytetarëve në bazë të situatës epidemiologjike, transporti urban dhe ndërrurban, taksitë, gastronomia në përgjithësi, provimet në arsimin e lartë, testi i maturës dhe i arritshmërisë, hapja e kinemave dhe teatrove, hapja selektive e aktiviteteve sportive.





# Agjencia e Punësimit

Për nevojat e këtij hulumtimi e takuam dhe zhvilluam intervistë me Drejtorin e Agjencisë së Punësimit (APRK), z Drin Haraçia.<sup>38</sup> Synimin e kishim që përmes të dhënave nga ky institucion të krijojmë një pasqyrë sa më të qartë të pasojave socio-ekonomike të shkaktuara nga pandemia Covid-19, me theks të veçantë te komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Ferizajt, të Lipjanit dhe të Fushë Kosovës. Në vijim janë përmbledhur statistikat e punësimit para dhe pas pandemisë:

- Deri më 21 maj 2020, numri i përgjithshëm i punëkërkuarve të regjistruar në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës është 162.952, prej të cilëve 73.803 gra dhe 89.149 burra.
- Para shpërthimit të pandemisë, të punësuar ishin rreth 365.000 persona, 80.000 prej të cilëve në sektorin publik. Të punësuar gjatë

muajit prill dhe maj 2020 janë 9 persona.

- Gjatë muajit prill 2020, janë regjistruar 32.377 të papunë, prej të cilëve 14.849 gra dhe 17.528 burra.

Kjo shifër e të regjistruarve të papunë gjatë muajit prill 2020 lidhet me fillimin e zbatimit të Pakos Emergjente Fiskale. Për të përfituar nga masat e saj kërkohej regjistrimi dhe formalizimi i gjendjes. Me qëllimin që të përfitonin nga masat, u regjistruan shumë të papunë në APRK, gjë që nuk do të ndodhte po të mos hapej Pakoja Emergjente për situatë pandemie.

- Numri i personave të papunë nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian në komunën e Fushë Kosovës, të Lipjanit dhe të Ferizajt prej 1 janarit 2020 deri më 13 mars 2020 (para pandemisë Covid-19):

**Ferizaj:** romë 44, ashkalinj 809, egjiptianë 3;

**Lipjan:** romë 47, ashkalinj 296, egjiptianë 1;

**Fushë Kosovë:** romë 80, ashkalinj 698, egjiptianë 33.

- Të regjistruar si të papunë gjatë muajit prill 2020 në tri komunat:

**Ferizaj:** romë 3, ashkalinj 88, egjiptianë 5;

**Lipjan:** romë 17, ashkalinj 69, egjiptianë 0;

**Fushë Kosovë:** romë 2, ashkalinj 13, egjiptianë 3.

Nga statistikat e APRK-së për muajin prill 2020 shohim se komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian nuk ka qenë mjaftueshëm i informuar për Pakon Emergjente Fiskale, përkatësisht për mundësinë e përfitimit nga masa 15. Duke e njohur faktin se papunësia te këto komunitete shkon deri në 35%, sipas raportit të Organizatës Botërore të Punës,<sup>39</sup> numri i të papunëve të regjistruar gjatë muajit prill 2020 do të duhej të ishte shumë më i lartë. Për të përfituar nga masa 15 (ndihma prej 130 eurosh për familjet që nuk kanë asnjë të ardhur nga buxheti i shtetit ose nga sektori privat) fillimisht duhej të regjistroheshin si të papunë.



# Zbatimi i Masave Kufizuese – Policia e Kosovës

Duke pasur parasysh gjendjen e jashtëzakonshme që shkaktoi shfaqja e pandemisë Covid-19 si dhe duke marrë në konsideratë kufizimet e lirisë së lëvizjes, kufizimet e qarkullimit dhe ndalesat e tjera ekonomike, e vlerësuam të rëndësishme përfshirjen e informacioneve që vijnë nga organet e zbatimit të rendit dhe ligjit. Për këtë arsye i dërguam kërkesë për qasje në dokumente publike Policisë së Kosovës (PK) në Prishtinë, Ferizaj, Lipjan dhe Fushë Kosovë.<sup>40</sup> Në vijim janë përmbledhur të dhënat mbi zbatimin e masave kufizuese dhe jo vetëm, gjatë periudhës së pandemisë:

- Numri i rasteve të dhunës në familje, të raportuara në Policinë e Kosovës për periudhën mars-maj 2020 është:
  1. mars 2020: 169 raste, në mbajtje 67 persona,
  2. prill 2020: 167 raste, në mbajtje 85 persona,
  3. maj 2020: 174 raste , në mbajtje 77 persona.
- Gjatë muajve mars, prill dhe maj 2020 ka ngritje në raportimin e rasteve të dhunës në familje, krahasuar me periudhën e njëjtë të një viti më parë:
  1. më mars 2020 janë raportuar 169 raste, kurse në mars 2019 ishin raportuar 124 raste;
  2. në prill 2020 janë raportuar 167 raste, kurse në prill 2019 ishin raportuar 138 raste;
  3. në maj 2020 janë raportuar 174 raste, kurse në maj 2019 ishin raportuar 141 raste.
- Numri i rasteve të denoncuarra për dhunë në familje te komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian, për muajin mars 2020 është 10 raste, në muajin prill 12 raste dhe në muajin maj 10 raste.

## Fushë Kosovë

	Numri i përgjithshëm		Numri i personave të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian	
	Numri i arrestimeve	Numri i gjobave	Numri i arrestimeve	Numri i gjobave
<b>Mars</b>	9 persona të shoqëruar në stacion (jo të arrestuar)	0	0	0
<b>Prill</b>	44 persona të shoqëruar në stacion (jo të arrestuar)	17	3 persona të shoqëruar në stacion (jo të arrestuar)	0
<b>Maj</b>	12 persona të shoqëruar në stacion (jo të arrestuar)	190	0	13
<b>Gjithsej</b>	65 persona të shoqëruar në stacion	207	3 persona të shoqëruar në stacion	13

## Lipjan

	Numri i përgjithshëm		Numri i personave të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian	
	Numri i arrestimeve	Numri i gjobave	Numri i arrestimeve	Numri i gjobave
<b>Mars</b>	0	0	0	0
<b>Prill</b>	0	0	0	0
<b>Maj</b>	1	0	1	0
<b>Gjithsej</b>	1	0	1	0

Ferizaj				
	Numri i përgjithshëm		Numri i personave të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian	
	Numri i arrestimeve	Numri i gjobave	Numri i arrestimeve	Numri i gjobave
Mars	15	0	0	0
Prill	51	0	0	0
Maj	11	0	1	0
Gjithsej	77	0	1	0

Gjatë muajit prill 2020, me fillimin e kufizimeve të lëvizjes dhe të qarkullimit, duke përjashtuar Komunën e Lipjanit, në total ka rritje të dukshme të arrestimeve ose të shoqërimeve në polici në krahasim me muajin mars 2020. Gjatë muajit maj 2020 ka rritje të madhe të gjobave të shqiptuara si rezultat i mosrespektimit të masave të qeverisë për lëvizjen e lirë, në

krahasim me muajt mars dhe prill 2020. Nga radhët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian janë shqiptuar 13 gjoba në komunën e Fushë Kosovës. Ndërsa numri i arrestimeve është i vogël. Gjatë kohës së pandemisë Covid-19, në Fushë Kosovë ishin tri raste të shoqërimeve në polici, në komunën e Lipjanit vetëm 1 i arrestuar, kurse në Ferizaj nuk ka asnjë rast.



# Masat e Komunave për Menaxhimin e Pandemisë Covid-19

Qëllimi i dytë i këtij hulumtimi është identifikimi dhe shqyrtimi i masave të ndërmarra nga Komuna e Ferizajt, e Lipjanit dhe e Fushë Kosovës, me theks te komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian, në menaxhimin dhe zbutjen e pasojave të pandemisë Covid-19. Për këtë qëllim hulumtuam në faqet zyrtare të tri komunave, duke shqyrtuar të gjitha lajmet, njoftimet dhe vendimet që kishin të bënin me pandeminë Covid-19. Realizuam edhe takime me përfaqësues të shtabeve emergjente të tri komunave, si dhe zhvilluam intervista e pyetësorë me

drejtoritë përkatëse dhe koordinatorët e shtabeve emergjente. Projekti shtrihet në periudhën që nis më datën 13 mars – kur u paraqit rasti i parë me Covid-19 – e vazhdonn deri më 1 qershor 2020. Nënvizojmë se projekti ofron një analizë totale të veprimeve qeveritare dhe komunale, me theks në qasjen ndaj komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian përgjatë kësaj periudhe. Përkundër gjendjes emergjente, komunat e përfshira në hulumtimin tonë na janë përgjigjur në kohë rekorde, duke na takuar dhe duke na i ofruar të gjitha informacionet e kërkuara.



# Komuna e Ferizajt

Më 21 mars 2020 u konfirmua rasti i parë me Covid-19 në fshatin Bibaj të komunës së Ferizajt. Që nga fillimi i pandemisë deri më 1 qershor 2020, në komunën e Ferizajt janë testuar 600 qytetarë. Prej tyre, 141 kanë rezultuar pozitivë, 130 janë të shëruar, 2 kanë vdekur dhe 9 janë ende raste aktive. Nga radhët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian janë vetëm 2 të testuar (pjesëtarë të komunitetit ashkali), nuk ka të infektuar as të vdekur.

Për parandalimin dhe menaxhimin e gjendjes së krijuar nga pandemia, më 21 mars u themelua shtabi emergjent. Kuvendi Komunal ka mbajtur dy mbledhje të jashtëzakonshme, më 2 prill dhe 8 maj 2020. Në mbledhjen e parë u mor vendimi që të ndaheshin 200 mijë euro për parandalimin dhe menaxhimin e pandemisë. Mjetet u alokuan për furnizimin me pako ushqimore dhe higjienike për familjet me gjendje

të rëndë ekonomike, dezinfektimin e hapësirave publike, furnizimin me materiale dhe pajisje mjekësore, si dhe për nevoja të tjera që mund të rezultojnë nga pandemia.

Që nga fillimi i pandemisë janë dezinfektuar të gjitha institucionet publike, institucionet shkollore dhe parashkollore, palestrat sportive, objektet fetare, sheshi dhe rrugët e qytetit, si dhe rrugët e fshatrave. Janë dezinfektuar 52 xhami, 30 herë është dezinfektuar stacioni dhe veturat e policisë, objektet e banimit kolektiv, rrugët dhe lagjet kryesore të qytetit. Lagjja Sallahane, Halit Ibishi si dhe fshatrat Zaskok e Dubravë janë venbanimet e dezinfektuara, në të cilat janë më të koncentruar pjesëtarët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian.

Janë shpërndarë 5000 pako ushqimore dhe higjienike, prej tyre 1600 nga buxheti i Komunës. Gjithsej 1200 pako ushqimore

---

**Që nga fillimi i pandemisë deri më 1 qershor 2020, në komunën e Ferizajt janë testuar 600 qytetarë. Prej tyre, 141 kanë rezultuar pozitivë, 130 janë të shëruar, 2 kanë vdekur dhe 9 janë ende raste aktive.**

dhe higjienike janë shpërndarë për komunitetin rom, ashkali, egjiptian, pa lënë anash edhe komunitetin serb në Babush. Komuna e Ferizajt ka pranuar donacione të shumta dhe të ndryshme gjatë periudhës së pandemisë. Veçohen ndihmat me: 31 lloptopë, rreth 50 tablete, mbi 3000 pako ushqimore dhe higjienike, mbi 6000 maska, 200 dezinfektues, 200 kapela, 2 aparate për oksigjenim si dhe një kontigjent me pajisje mjekësore në vlerë prej 4000 eurosh.

Sipas intervistave të zhvilluara me Drejtorin e Arsimit, z. Afrim Llabjani,<sup>41</sup> dhe Drejtorin e Shëndetësisë e të Mirëqenies Sociale, z. Bekim Ademi, njëherit edhe Koordinator i Shtabit Emergjent të Ferizajt, mbarëvajtja e procesit mësimor në distancë ka shkuar mjaft mirë.<sup>42</sup> Përkundër sfidave të shumta, 94% e nxënësve të nivelit fillor dhe 91% e nxënësve të nivelit të mesëm të lartë kanë ndjekur mësimin në distancë. Gjithsej 1500 nxënës të të gjitha niveleve nuk janë përfshirë në procesin mësimor, për shkak të kushteve ekonomike dhe mungesës së pajisjeve teknologjike.

Shqetësuese mbetet pjesëmarrja në

mësimin online e nxënësve të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian. Në nivelin parafillor, nga gjithsej 55 nxënës, 48 nuk e kanë ndjekur mësimin; në nivelin fillor të ulët (klasat 1-5), nga 382 nxënës, 195 nuk e kanë ndjekur mësimin; në nivelin e mesëm të ulët (klasat 6-9), nga 284 nxënës, 147 nuk e kanë ndjekur mësimin; në nivelin e mesëm të lartë (klasat 10-12), nga 107 nxënës, 35 nuk e kanë ndjekur mësimin. Në total, nga 828 nxënës të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian, 425 ose 51% nuk e kanë ndjekur mësimin nga distanca. Nga gjithsej 1500 nxënës që nuk e kanë ndjekur procesin mësimor, 28% janë nxënës nga radhët e këtyre komuniteteve minoritare. Në asnjërin nga nivelet e arsimit nuk ka ndonjë mësimdhënës të rregullt nga radhët e komunitetit rom, ashkali ose egjiptian. Janë vetëm tre mësimdhënës të angazhuar në mësimin shtesë.

Përfitues të asistencës sociale janë 960 qytetarë, prej tyre 249 ashkalinj dhe 9 romë. Komuna e Ferizajt mohon të ketë pranuar ndihmë financiare nga Qeveria, përkatësisht nga MSh dhe MF. Thonë të mos kenë përfituar as nga Pakoja Emergjente Fiskale. Ka pranuar vetëm furnizimin me materiale dhe pajisje mjekësore.





# Komuna e Lipjanit

Më 19 mars 2020 u konfirmua rasti i parë me Covid-19 në fshatin Janjevë të komunës së Lipjanit. Që nga fillimi i Pandemisë deri më 1 qershor 2020, në komunën e Lipjanit janë testuar mbi 100 qytetarë. Prej tyre, 27 kanë rezultuar pozitivë, 17 janë të shëruar, kurse 10 janë ende raste aktive. Nuk ka asnjë rast të prekur nga radhët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian, kurse për numrin e të testuarve nuk kemi të dhëna.

Më 23 mars 2020 është mbajtur mbledhja e parë e jashtëzakonshme e Kuvendit Komunal, me ç'rast janë ndarë 170 mijë euro për parandalimin dhe menaxhimin e pandemisë Covid-19. Mjetet u alokuan për furnizimim me pako ushqimore dhe higjienike për familjet me gjendje të rëndë ekonomike,

për dezinfektimin e hapësirave publike, furnizimin me materiale dhe pajisje mjekësore, si dhe për nevoja të tjera që mund të rezultojnë nga pandemia. Gjatë kësaj periudhe janë mbajtur edhe dy seanca të tjera të KK. Për menaxhimin e situatës emergjente, më 2 prill 2020 u themelua shtabi emergjent që kryesohej nga Kryetari i Komunës, z. Imri Ahmeti.

Që nga fillimi i pandemisë janë dezinfektuar të gjitha institucionet publike, objektet shkollore dhe parashkollore, rrugët e qytetit dhe rrugët e fshatrave, sheshi i qytetit e objektet fetare, dhe është vendosur një stacion dezinfektimi në hyrje të QKMF-së. Janë dezinfektuar edhe fshatrat Janjevë, Sillovi dhe Gadime, ku janë më të koncentruar pjesëtarët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian.

---

**Që nga fillimi i pandemisë deri më 1 qershor 2020, në komunën e Lipjanit janë testuar mbi 100 qytetarë. Prej tyre, 27 kanë rezultuar pozitivë, 17 janë të shëruar, kurse 10 janë ende raste aktive.**

Komuna e Lipjanit ishte furnizuar me disa pajisje shumë të nevojshme për QKMF-në, si aparatet për oksigjenim, aparatet defibrilatorë dhe aparatet e EKG-së.

Janë shpërndarë rreth 5000 pako ushqimore dhe higjienike, prej të cilave 2000 (40%) i janë dedikuar komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian. Me vendim të Kryetarit të Komunës, z. Imri Ahmeti, 23 fëmijë pa përkujdesje prindore janë ndihmuar me nga 300 euro. Komuna e Lipjanit ka pranuar edhe donacione të shumta e të ndryshme nga organizata joqeveritare vendore e ndërkombëtare, biznese lokale dhe individë. Gjatë kësaj periudhe, në total, Komuna ka pranuar mbi 2000 pako ushqimore dhe higjienike, 600 maska dhe materiale mjekësore në vlerë prej 2000 eurosh.

Sipas intervistave të zhvilluara me Nënkryetarin nga radhët e komuniteteve, Lulzim Qerimi, dhe Drejtoreshën e Arsimit, Elmaze Behluli, mbarëvajtja e procesit mësimor në distancë ka shkuar mirë.<sup>43</sup> Por kjo nuk mund të thuhet edhe për nxënësit e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian. Në nivelin fillor dhe të mesëm të ulët, nga 441 nxënës, mësimin nuk e kanë ndjekur 115 ose 26%, ndërsa në nivelin e mesëm të lartë, nga 30 nxënës, mësimin nuk e kanë ndjekur 19 ose 63% e nxënësve të këtyre komuniteteve.

Komuna e Lipjanit mohon të ketë pranuar ndihmë financiare nga Qeveria, përkatësisht nga MSh dhe MF. As nga Pakoja Emergjente Fiskale nuk kanë përfituar ende. Kanë pranuar vetëm furnizimin me materiale mjekësore për QKMF-të.



# Komuna e Fushë Kosovës

Më 30 mars 2020 u konfirmua rasti i parë me Covid-19 në Komunën e Fushë Kosovës. Që nga fillimi i pandemisë deri më 1 qershor 2020, në këtë komunë janë testuar gjithsej 194 qytetarë. Prej tyre, 8 kanë rezultuar pozitivë, por që të gjithë janë shëruar. Nuk ka asnjë rast të prekur nga radhët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian, kurse për numrin e të testuarve nuk kemi të dhëna.

Më 30 mars 2020 u mbajt mbledhja e Kuvendit Komunal, me ç'rast u ndanë 404.000 euro për parandalimin dhe menaxhimin e pandemisë Covid-19. Mjetet u alokuan për furnizimin me pako ushqimore dhe higjienike, dezinfektimin e hapësirave publike, si dhe për materiale e pajisje mjekësore. Për menaxhimin e situatës emergjente, më 18 mars 2020 u themelua shtabi emergjent që kryesohej

nga Kryetari i Komunës, Burim Berisha. Në kuadër të shtabit u funksionalizua edhe nënshtabi për komunitetet romë, ashkalinj dhe egjiptianë, i udhëhequr nga Nënkryetari për Komunitete, z. Qerim Gara.

Që nga fillimi i pandemisë Covid-19 janë dezinfektuar të gjitha institucionet publike, qendrat sportive, bizneset, objektet fetare, rrugët e qytetit, të gjitha rrugët e fshatrave, si dhe ndërtesat kolektive të banimit. Janë hequr mbeturinat nga lagjja 028' dhe 029'. Më 27 prill 2020 ka vazhduar faza e dytë e dezinfektimit. Më 1 qershor janë dezinfektuar të gjitha objektet shkollore dhe parashkollore.

Janë shpërndarë 2700 pako ushqimore, 1500 pako higjienike, 150 pako me produkte qumështi dhe 35.000 kg miell. Duke nisur nga data 21 prill, përditë janë shpërndarë nga 100 pako ushqimore për familjet në

---

**Që nga fillimi i pandemisë deri më 1 qershor 2020, në këtë komunë janë testuar gjithsej 194 qytetarë. Prej tyre, 8 kanë rezultuar pozitivë, por që të gjithë janë shëruar.**

nevojë. Komuna ka pranuar donacione nga organizata joqeveritare vendore e ndërkombëtare, shoqata humanitare dhe biznese lokale. Donacionet ishin në miell, pako ushqimore e higjienike, maska, dorëza dhe dezinfektues.

Përfitues të asistencës sociale janë 849 qytetarë, prej të cilëve 490 ose 57.7% nga radhët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian.

Mësimi në distancë u zhvillua në të gjitha shkollat, që nga data 23 mars 2020. Pjesëmarrja e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në mësimin online ishte e kënaqshme, megjithatë nuk u prezantua

numerikisht pjesëmarrja e personelit shkollor e as e nxënësve në procesin mësimor. Komuna ka pranuar ndihmë nga MASH dhe nga organizata joqeveritare Ballkan Sunflower, me pajisje teknologjike (llaptop dhe tabletë).

Komuna e Fushë Kosovës deklaroi se nuk ka pranuar asnjë ndihmë financiare nga niveli qendror. As nga Pakoja Emergjente Fiskale. Ka pranuar vetëm furnizime me material shpenzues për Qendrën e Mjekësisë Familjare. Për masën 15 të Pakos Emergjente Fiskale, Komuna pohon se kanë aplikuar gjithsej 1270 qytetarë.<sup>44</sup>



# Menaxhimi i Pandemisë sipas Njohësve dhe Aktivistëve të të Drejtave të Komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian

Për të pasur një pamje më complete mbi gjendjen e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian, të shkaktuar pas emergjencës shëndetësore, si dhe për të vlerësuar më gjerësisht punën e institucioneve qeveritare dhe atë atyre lokale, realizuam takime dhe intervista me njohës e aktivistë për të drejtat e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian.

Të gjithë të intervistuarit pa përjashtim pajtohen se situata emergjente e shkaktuar nga pandemia Covid-19 është menaxhuar përgjithësisht me mjaft profesionalizëm. Senad Ibishi nga organizata Voice of Roma, Ashkali and Egyptians (VoRAE)<sup>45</sup> deklaroi se pavarësisht kritikave për ligjshmërinë e masave, niveli qendror, në veçanti Ministria e Shëndetësisë, me sukses e arriti parandalimin e pandemisë Covid-19. Denur Paçaku, aktivist i shoqërisë civile,<sup>46</sup> suksesin në menaxhimin e situatës ia atribuon edhe angazhimin e organizatave nga shoqëria civile.

Megjithatë, sa i takon menaxhimin të pandemisë Covid-19 te komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian kemi tjetër rrëfim. Aktivisti dhe njohësi i problematikave të pakicave etnike, Gazmend Salijeviç<sup>47</sup> thotë se situata emergjente nxori në pah problemet strukturore që ka shoqëria dhe dështimin e shtetit për përmirësimin dhe integrimin e komuniteteve joshumicë.

Përgjithësisht nga intervistat mund të konkludohet se menaxhimi i Covid-19, më parë sesa nga institucionet qendrore u krye nga organizatat joqeveritare, shoqatat humanitare dhe aktivistë vullnetarë. Përjashtojmë komunën e Lipjanit, të Fushë Kosovës dhe të Ferizajt, komunat kanë dështuar t'i adresojnë nevojat e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian.

Sipas Senad Ibishit, këto komunitete nuk morën mbështetjen e nevojshme

institucionale, herë-herë duke u përjashtuar edhe nga ofrimi i pakove ushqimore e higjienike që janë shpërndarë nga niveli lokal. Kurse sipas Driton Berishës nga Roma Education Fund (REF)<sup>48</sup>, aktivizmi vullnetar bashkë me nënshtabet emergjente, sidomos në Fushë Kosovë, ka bërë punë të mirë në adresimin e nevojave të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian.

Të intervistuarit janë të pakënaqur edhe me thirrjen e Qeverisë të datës 23 prill 2020 për mbështetje financiare të organizatave joqeveritare që merren me mbrojtjen, përmirësimin dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve pakicë në Republikën e Kosovës. Senad Ibishi pretendon se procesi i përzgjedhjes ka pasur shumë defekte, pasi janë shkelur

kriteret kryesore të përzgjedhjes së OJQ-ve për implementimin e këtyre mjeteve. Do të duhej të përfitonin organizatat me përvojë në fushën e mbrojtjes dhe avokimit për të drejtat e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian, mendon Driton Berisha. Më i ashpër është Gazmend Salijeviç, i cili thotë se nuk mund të marrësh grant pa e pasur dikë në Qeveri.

Pak organizata që merren me komunitetin rom, ashkali dhe egjiptian janë në listën e përfituesve. Shumë prej organizatave përfituese kanë lidhje me Listën Serbe dhe kanë marrë grante për shkak të ndikimit të saj. Muhamet Arifi nga Ballkan Sunflower<sup>49</sup> mendon se Qeveria nuk ka bërë asgjë konkrete për komunitetet. Shton se as masa 9, që

---

**Të intervistuarit janë të pakënaqur edhe me thirrjen e Qeverisë të datës 23 prill 2020 për mbështetje financiare të organizatave joqeveritare që merren me mbrojtjen, përmirësimin dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve pakicë në Republikën e Kosovës. Ata pretendojnë se procesi i përzgjedhjes ka pasur shumë defekte, pasi janë shkelur kriteret kryesore të përzgjedhjes së OJQ-ve për implementimin e këtyre mjeteve, kurse shtojnë se nuk mund të marrësh grant pa e pasur dikë në Qeveri.**

parashikonte ndarjen e 2 milion eurove, ende nuk është përmbushur. Kritik është edhe për organizatat fituese në listën preliminare. Njëjtë mendon edhe artisti e aktivisti Bajram Kinolli<sup>50</sup> sa i takon masës 9. Sipas tij, në bazë të emrave të organizatave përfituese, të shpallura në listën preliminare, mund të konstatohet se thirrja e konkursit nuk është respektuar.

Shqetësim mbetet pjesëmarrja në procesin edukativo-arsimor gjatë kohës së pandemisë Covid-19. Për shkak të varfërisë, e për rrjedhojë mungesës së pajisjeve teknologjike, pjesëtarët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian e kishin të pamundshme ta ndiqnin mësimin nga distanca. Senad Ibishi pohon se me donacionet e njerëzve

vullnetmirë, me mbështetjen e komunave e të ambasadave të huaja të akredituara në Kosovë, kanë siguruar pajisje teknologjike për t'iu mundësuar nxënësve romë, ashkalinj dhe egjiptianë përcjelljen e mësimin online. Në anën tjetër, Driton Berisha beson se mungesa e kushteve për ndjekjen e mësimin do të shkaktojë pasoja të mëdha te komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian, duke rritur edhe më shumë numrin e atyre që braktisin shkollimin. Osman Osmani, nga BRO "Nevo Koncepti"<sup>51</sup> deklaroi se 20-40% të nxënësve nga radhët e komunitetit nuk kanë qenë fare të inkuadruar në mësimin online. Osmani mendon se përfaqësuesit politikë të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian kanë dështuar në përfaqësimin e interesave dhe brengave të tyre.



# Përfundime

- Deri më 1 qershor 2020, numri i të testuarve për Covid-19 në Republikën e Kosovës është 14.968, i të vdekurve 30, i të shëruarve 873 dhe i rasteve aktive me virusin korona 210.
- Më 21 mars 2020 u konfirmua rasti i parë me Covid-19 në Komunën e Ferizajt. Deri më 1 qershor 2020 në këtë komunë janë testuar 600 qytetarë. Prej tyre, 141 kanë rezultuar pozitivë, 130 janë të shëruar, 2 janë të vdekur dhe 9 janë ende raste aktive. Nga radhët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian janë vetëm 2 të testuar (pjesëtarë të komunitetit ashkali), kurse nuk ka të infektuar dhe as të vdekur.
- Më 19 mars 2020 u konfirmua rasti i parë me Covid-19 në Komunën e Lipjanit. Deri më 1 qershor 2020 në këtë komunë janë testuar mbi 100 qytetarë. Prej tyre, 27 kanë rezultuar pozitivë, 17 janë të shëruar, kurse 10 janë ende raste aktive. Nuk ka asnjë rast të prekur nga radhët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian, kurse për numrin e gjithsejtë të të testuarve nga këto komunitete nuk kemi të dhëna.
- Më 30 mars 2020 u konfirmua rasti i parë me Covid-19 në Komunën e Fushë Kosovës. Deri më 1 qershor 2020 në këtë komunë janë testuar gjithsej 194 qytetarë. Prej tyre, 8 kanë rezultuar pozitivë, por që të gjithë janë shëruar. Nuk ka asnjë rast të prekur nga radhët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian, kurse nuk kemi të dhëna për numrin e të testuarve nga këto komunitete.
- Nga gjithsej 27 vendime të Qeverisë së Kosovës për menaxhimin e pandemisë Covid-19, vetëm njëri vendim lidhet me komunitetet romë, ashkalinj dhe egjiptianë.



- Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike nuk kanë të dhëna mbi përhapjen dhe menaxhimin e pandemisë Covid-19 te komunitetet romë, ashkalinj dhe egjiptianë.
- Ministria e Arsimit dhe Shkencës nuk i ka pasur parasysh nevojat e nxënësve të komuniteteve romë, ashkalinj dhe egjiptianë kur e ka filluar organizimin e mësimit nga distanca. Mungesa e qasjes në internet dhe mungesa e pajisjeve teknologjike (llaptopë, tabletë) ka ndikuar në pjesëmarrjen e ulët në procesin edukativo-mësimor të nxënësve nga këto komunitete.
- Në Komunën e Ferizajt, nga 828 nxënës të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian, 425 ose 51% nuk e kanë ndjekur mësimin nga distanca. Nga gjithsej 1500 nxënës që nuk e kanë ndjekur procesin mësimor, 28% janë nxënës nga radhët e komuniteteve. Në asnjërin nga nivelet e arsimit nuk ka ndonjë mësimdhënës të rregullt nga radhët e komuniteteve romë, ashkalinj dhe egjiptianë. Janë vetëm tre mësimdhënës të angazhuar në mësimin shtesë.
- Në Komunën e Lipjanit, nga 441 nxënës të komuniteteve romë, ashkalinj dhe egjiptianë, në nivelin fillor dhe të mesëm, mësimin nuk e kanë ndjekur 115 ose 26%, ndërsa në nivelin e mesëm të lartë, nga 30 nxënës, mësimin nuk e kanë ndjekur 19 ose 63% e tyre.
- Në Komunën e Fushë Kosovës, mësimi në distancë është zhvilluar në të gjitha shkollat, që nga data 23 mars 2020. Mirëpo, pjesëmarrja në mësimin online e personelit shkollor, e as ajo e nxënësve nga radhët e komuniteteve romë, ashkalinj dhe egjiptianë nuk është prezantuar numerikisht.
- Njohës dhe aktivistë për të drejtat e komuniteteve romë, ashkalinj dhe egjiptianë kanë kritikuar ndarjen e granteve për mbështetje financiare të organizatave joqeveritare që merren me mbrojtjen, përmirësimin dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve pakicë në Republikën e Kosovës. Nga lista preliminare e përfutësve të granteve shihet se nuk është respektuar thirrja e Qeverisë e datës 23 prill 2020, pasi në të ka pak organizata që merren me komunitetet romë, ashkalinj dhe egjiptianë.
- Barrën kryesore për lehtësimin e situatës së shkaktoar nga pandemia te komunitetet romë, ashkalinj dhe egjiptianë në komunën e Ferizajt, të Fushë Kosovës dhe të Lipjanit e kanë pasur përfaqësuesit lokalë të komuniteteve, së bashku me organizatat joqeveritare dhe shoqatat humanitare.

- Komuna e Fushë Kosovës është e vetmja që për menaxhimin e situatës së shkaktuar nga pandemia Covid-19, ka themeluar nënshtabin e komuniteteve të udhëhequr nga nënkryetari për komunitete, z. Qerim Gara. Komuna e Lipjanit ka deleguar nënkryetarin për komunitete, z. Lulzim Qerimi, për menaxhimin e pandemisë Covid-19 te komunitetet romë, ashkalinj dhe egjiptianë. Komuna e Ferizajt nuk ka caktuar asnjë përgjegjës që të merret veçanërisht me komunitetet pakicë.
- Sipas të dhënave nga Agjencia e Statistikave vetëm gjatë muajit prill 2020 janë regjistruar 32.377 qytetarë të rinj si të papunë. Kjo shifër e lartë lidhet me fillimin e zbatimit të Pakos Emergjente Fiskale.
- Komunitetet romë, ashkalinj dhe egjiptianë nuk kanë qenë të informuar sa duhet për masën 15 të Pakos Emergjente Fiskale, e cila për qytetarët me kushte të rënda ekonomike parasheh asistencën sociale për periudhën prill-qershor 2020, në vlerë prej 130 eurosh në muaj. Një nga indikatorët kryesorë për këtë është mungesa e regjistrimit të pjesëtarëve të këtyre komuniteteve si të papunë në qendrat e punësimit. Të regjistruar si të papunë gjatë muajit prill 2020 në Ferizaj janë 3 romë, 88 ashkalinj dhe 5 egjiptianë; në Lipjan 17 romë, 69 ashkalinj dhe asnjë egjiptian; ndërsa në Fushë Kosovë 2 romë, 13 ashkalinj dhe 3 egjiptianë.
- Gjatë muajit mars, prill dhe maj 2020 ka ngritje të raportimit të rasteve të dhunës në familje në krahasim me vitin paraparok. Në mars 2020 janë raportuar 169 raste, kurse në mars 2019 ishin raportuar 124 raste; në prill 2020 janë raportuar 167 raste, kurse në prill 2019 ishin raportuar 138 raste; në maj 2020 janë raportuar 174 raste, kurse në maj 2019 ishin raportuar 141 raste.
- Numri i rasteve të denoncuar për dhunë në familje te komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian gjatë vitit 2020, për muajin mars është 10, për muajin prill 12 dhe për muajin maj 10.
- Me fillimin e kufizimeve të lëvizjes, gjatë muajit prill 2020 në Komunën e Ferizajt dhe të Fushë Kosovës ka rritje të dukshme të arrestimeve ose të shoqërimeve në polici, krahasuar me muajin mars. Në Komunën e Fushë Kosovës, nga 9 shoqërime në polici gjatë muajit mars, ka ngritje në 44 raste në muajin maj. Në Komunën e Ferizajt, nga 15 të shoqëruar në polici në muajin prill, ka ngritje në 51 raste në muajin maj. Në Komunën e Lipjanit ka vetëm një arrestim gjatë muajit maj.
- Në Komunën e Fushë Kosovës gjatë marsit e prillit 2020 janë shqiptuar 17 gjoba, si rezultat i mosrespektimit të masave të Qeverisë për kufizimin e lëvizjes. Në muajin maj ka një rritje enorme në 197 gjoba. Në Komunën e Ferizajt dhe atë të Lipjanit nuk ka asnjë gjobë të shqiptuar gjatë muajve mars, prill e maj.

- Në Fushë Kosovë gjatë muajit prill janë shoqëruar në polici tre qytetarë nga radhët e këtyre komuniteteve, në komunën e Lipjanit një qytetar është arrestuar në muajin maj, kurse në komunën e Ferizajt nuk ka asnjë rast.
- Nga fillimi i pandemisë deri më 1 qershor 2020, Komuna e Ferizajt ka shpërndarë 5000 pako ushqimore dhe higjienike, prej tyre 1600 nga buxheti i Komunës. Gjithsej 1200 pako ushqimore dhe higjienike janë shpërndarë për komunitetin rom, ashkali e egjiptian, pa lënë anash edhe komunitetin serb në Babush. Komuna e Lipjanit ka shpërndarë rreth 5000 pako ushqimore dhe higjienike, prej të cilave 2000 (40%) i janë dedikuar komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian. Me vendim të Kryetarit të Komunës, z. Imri Ahmeti, 23 fëmijë pa përkujdesje prindore janë ndihmuar me nga 300 euro për secilin. Komuna e Fushë Kosovës ka shpërndarë 2700 pako ushqimore, 1500 pako higjienike, 150 pako me produkte qumështi dhe 35.000 kg miell. Nga 21 prilli, çdo ditë ka shpërndarë nga 100 pako ushqimore për familjet në nevojë.



# Fundnotat

- 1 Raporti i Progresit 2019, faqe 31, gjendet në: <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-kosovo-report.pdf>
- 2 Organizata Ndërkombëtare e Punës «Perspektivat e të rinjve romë, ashkalinj dhe egjiptianë mbi mundësitë dhe sfidat për punë të denjë në Kosovë», 2018, faqe 19, gjendet në: [https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---europe/---ro-geneva/---sro-bu-dapest/documents/publication/wcms\\_648879.pdf](https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---europe/---ro-geneva/---sro-bu-dapest/documents/publication/wcms_648879.pdf)
- 3 Po aty, faqe 20.
- 4 OSBE «Pasqyrë e Komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian të Kosovës», 2020, faqe 5, gjendet në: [https://www.osce.org/files/f/documents/c/c/443590\\_2.pdf](https://www.osce.org/files/f/documents/c/c/443590_2.pdf)
- 5 Ligji për Shërbim Civil të Republikës së Kosovës, 25 qershor 2010, faqe 5, gjendet në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2679>
- 6 Organizata Ndërkombëtare e Punës «Perspektivat e të rinjve romë, ashkalinj dhe egjiptianë mbi mundësitë dhe sfidat për punë të denjë në Kosovë», 2018, faqe 18, gjendet në: [https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---europe/---ro-geneva/---sro-bu-dapest/documents/publication/wcms\\_648879.pdf](https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---europe/---ro-geneva/---sro-bu-dapest/documents/publication/wcms_648879.pdf)
- 7 Raporti i Progresit 2010, faqe 36, gjendet në: [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key\\_documents/2010/package/ks\\_rapport\\_2010\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2010/package/ks_rapport_2010_en.pdf)

- 8 Organizata Ndërkombëtare e Punës «Perspektivat e të rinjve romë, ashkalinj dhe egjiptianë mbi mundësitë dhe sfidat për punë të denjë në Kosovë», 2018, faqe 16, gjendet në: [https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---europe/---ro-geneva/---sro-bu-dapest/documents/publication/wcms\\_648879.pdf](https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---europe/---ro-geneva/---sro-bu-dapest/documents/publication/wcms_648879.pdf)
- 9 Shih vendimin numër 07/04 në: <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/03/Vendimet-e-Mbledhjes-s%C3%AB-4-t%C3%AB-t%C3%AB-Queveris%C3%AB-s%C3%AB-Republik%C3%ABs-s%C3%AB-Kosov%C3%ABs-2020.pdf>
- 10 Shih vendimin numër 04/06 në: <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/03/Vendimet-e-Mbledhjes-s%C3%AB-6-t%C3%AB-t%C3%AB-Queveris%C3%AB-s%C3%AB-Republik%C3%ABs-s%C3%AB-Kosov%C3%ABs-2020.pdf>
- 11 Shih vendimin numër 01/07 në: <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/03/Vendimet-e-Mbledhjes-s%C3%AB-7-t%C3%AB-t%C3%AB-Queveris%C3%AB-s%C3%AB-Republik%C3%ABs-s%C3%AB-Kosov%C3%ABs-2020.pdf>
- 12 Shih vendimin numër 01/09 në: <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/03/Scan-14-Mar-2020.pdf>
- 13 Shih vendimin numër 01/13 në: <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/03/Vendim-i-Mbledhjes-s%C3%AB-13-t%C3%AB-t%C3%AB-Queveris%C3%AB-s%C3%AB-Republik%C3%ABs-s%C3%AB-Kosov%C3%ABs.pdf>
- 14 Shih vendimin numër 01/15 në: [https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/03/Vendimet-e-Mbledhjes-s%C3%AB-15-t%C3%AB-t%C3%AB-Queveris%C3%AB-s%C3%AB-Republik%C3%ABs-s%C3%AB-Kosov%C3%ABs.pdf?\\_\\_cf\\_chl\\_jschl\\_tk\\_\\_=0e7956f07973070812568bf7f703e82745d7eaff-1590760795-0-ARc1XM3xUXFU4nAd9rGtvdrY02Asg2tx-u-9RaBeRR1kXUMPyXVlqE9pww-YA7TrXgXOB0Ub7kjN50PT7JtJTFdlPtx3LnxD7GMQHejQe7CwK\\_E1Yc9hKY9Vtx-J56iQewhj5MUHGMCUI5FGYmMrSMhLRy3hHY0c\\_xmFEfjbKXkQY7mL2\\_qrD-M09Cm\\_8i6PRmPCghyeGaLAzpF6Q1aP1pJuIPTkcHAcGozL4fWxJc1i-A5U-e3qY-HP-bSC6wpERL\\_Sug5NMvFTwlksAXOXghIcxjMsVYe6nB\\_KjH88OjS6sBUf-bx-Ou-vmEXVuP-6HpKmqFyuME0wrfopSrutTynUgkJbJb6w-OsptB7Hu7iqUQV6JXWGlGW-Wo0g4Fo8lpRenFYUEFmUNdkPUH\\_ECac0W4TcOHDEq0KlMuG1P-YyK9yDhh6ls-JOvE-5vxVOfdhrajM2lwggkS6FiKpfr2yhzkoCw](https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/03/Vendimet-e-Mbledhjes-s%C3%AB-15-t%C3%AB-t%C3%AB-Queveris%C3%AB-s%C3%AB-Republik%C3%ABs-s%C3%AB-Kosov%C3%ABs.pdf?__cf_chl_jschl_tk__=0e7956f07973070812568bf7f703e82745d7eaff-1590760795-0-ARc1XM3xUXFU4nAd9rGtvdrY02Asg2tx-u-9RaBeRR1kXUMPyXVlqE9pww-YA7TrXgXOB0Ub7kjN50PT7JtJTFdlPtx3LnxD7GMQHejQe7CwK_E1Yc9hKY9Vtx-J56iQewhj5MUHGMCUI5FGYmMrSMhLRy3hHY0c_xmFEfjbKXkQY7mL2_qrD-M09Cm_8i6PRmPCghyeGaLAzpF6Q1aP1pJuIPTkcHAcGozL4fWxJc1i-A5U-e3qY-HP-bSC6wpERL_Sug5NMvFTwlksAXOXghIcxjMsVYe6nB_KjH88OjS6sBUf-bx-Ou-vmEXVuP-6HpKmqFyuME0wrfopSrutTynUgkJbJb6w-OsptB7Hu7iqUQV6JXWGlGW-Wo0g4Fo8lpRenFYUEFmUNdkPUH_ECac0W4TcOHDEq0KlMuG1P-YyK9yDhh6ls-JOvE-5vxVOfdhrajM2lwggkS6FiKpfr2yhzkoCw)
- 15 Shih vendimin numër 01/16 në: <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/03/Vendim-i-Mbledhjes-s%C3%AB-16-t%C3%AB-t%C3%AB-Queveris%C3%AB-s%C3%AB-Republik%C3%ABs-s%C3%AB-Kosov%C3%ABs.pdf>

- 16 Shih vendimin numër 01/19 në: [https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/03/Vendimi-i-Qeveris%C3%AB-nga-Mbledhja-e-19.pdf?\\_\\_cf\\_chl\\_jschl\\_tk\\_\\_=857580d098d9bae6df03e4c5dc32cc143aaa8ae4-1590764975-0-AVBSe4SodTUx9bgV1Gaf3fFsjGcVL1JJ6rTQHMHOAZyMdj8PDshwPBauWaBgNU\\_L2XavK9Hif9XvCgJuhxePx0bW8idvtag1BXntSQRdTj2FwdcONQhqD78vK6-ytYrhIAf-He9OmwfeHqH1YpyMkasYBTvCXzzKcASnDXlGBuLAtKOgvlLWLn1x-jfU16acZc2Y-PERQK4zM\\_CeI-XaxSWJyIx1Sc0odFoY04jQGk7P8ig3FdEiHm03qdfCbo47msZgn-TZ7eXgv\\_728A\\_vGyD7HUGxbMlBTjPBozeNj7sIpD0MFl1VM4fJKc1bCFQhE\\_7rQur-Q8GwtgLLab2W8KT2uH6SIUA2zKRQyGDc2gha8jPtzMpw09ORfFPJzFYuqhPedA](https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/03/Vendimi-i-Qeveris%C3%AB-nga-Mbledhja-e-19.pdf?__cf_chl_jschl_tk__=857580d098d9bae6df03e4c5dc32cc143aaa8ae4-1590764975-0-AVBSe4SodTUx9bgV1Gaf3fFsjGcVL1JJ6rTQHMHOAZyMdj8PDshwPBauWaBgNU_L2XavK9Hif9XvCgJuhxePx0bW8idvtag1BXntSQRdTj2FwdcONQhqD78vK6-ytYrhIAf-He9OmwfeHqH1YpyMkasYBTvCXzzKcASnDXlGBuLAtKOgvlLWLn1x-jfU16acZc2Y-PERQK4zM_CeI-XaxSWJyIx1Sc0odFoY04jQGk7P8ig3FdEiHm03qdfCbo47msZgn-TZ7eXgv_728A_vGyD7HUGxbMlBTjPBozeNj7sIpD0MFl1VM4fJKc1bCFQhE_7rQur-Q8GwtgLLab2W8KT2uH6SIUA2zKRQyGDc2gha8jPtzMpw09ORfFPJzFYuqhPedA)
- 17 Shih vendimin numër 01/24 në: <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/04/Vendim-i-mbledhjes-s%C3%AB-24-t%C3%AB-t%C3%AB-Qeveris%C3%AB.pdf>
- 18 Shih vendimin numër 11/26 në: <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/04/Vendimet-e-mbledhjes-s%C3%AB-26-t%C3%AB-t%C3%AB-Qeveris%C3%AB.pdf>
- 19 Shih vendimin numër 02/35 në: <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/05/Vendimet-e-mbledhje-s%C3%AB-35-t%C3%AB-t%C3%AB-Qeveris%C3%AB.pdf>
- 20 Shih vendimin numër 02/38 në: <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/05/Vendimet-e-mbledhjes-s%C3%AB-38-t%C3%AB-t%C3%AB-Qeveris%C3%AB-.pdf>
- 21 Shih vendimin e MASH në: <https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/03/de-tyrat-dhe-perjegjesite-per-realizimin-e-mesimit-ne-distance-mashti.pdf>
- 22 Shih vendimin e MASH në: <https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/03/udhezime-per-drejtorite-komunale-te-arsimit-per-realizimin-e-mesimit-online-per-shkollat-e-mesme-te-larta-profesionale-shml-dhe-qendrat-e-kompetences-mashti.pdf>
- 23 Shih vendimin e MASH në: <https://masht.rks-gov.net/e-mesimi>
- 24 Shih vendimin e MASH në: <https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/04/udhezu-es-per-vleresimin-e-nxenesve-gjate-mesimit-ne-distance.pdf>
- 25 Shih vendimin e MASH në: [https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/05/informata-udhezime-dhe-rregulla-per-kandidatet-maturantet-provimi-i\\_1.pdf](https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/05/informata-udhezime-dhe-rregulla-per-kandidatet-maturantet-provimi-i_1.pdf)

- 26 Intervistë përmes email-it me zyrtarë nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, 9 qershor 2020, Prishtinë.
- 27 Shih vendimin numër 35/2020 në: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/0F5A3F65-6780-421E-8290-2C072A383128.pdf>
- 28 Shih njoftimin në: [http://www.atk-ks.org/wp-content/uploads/2020/04/UdhezuesPageseShtese.pdf?fbclid=IwAR19yRczsPSFbhWyM2STK0ncFjPZlfcPah5mai4Cb9T-1Tu\\_pxkWzyy5ruUU](http://www.atk-ks.org/wp-content/uploads/2020/04/UdhezuesPageseShtese.pdf?fbclid=IwAR19yRczsPSFbhWyM2STK0ncFjPZlfcPah5mai4Cb9T-1Tu_pxkWzyy5ruUU)
- 29 Shih vendimin me numër 31-2/2020 në: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/DF-BCF0BA-6248-4583-B8CA-A886119639E8.pdf>
- 30 Shih udhëzuesin në: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/2684D970-C05A-401B-9C3D-247F1814A381.pdf>
- 31 Shih vendimin në: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/50CBC5FB-E931-4841-B88A-537507A0DA3A.png>
- 32 Shih vendimin numër 01/15 në: [https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/03/Vendimet-e-Mbledhjes-s%C3%AB-15-t%C3%AB-t%C3%AB-Qeveris%C3%AB-s%C3%AB-Republik%C3%ABs-s%C3%AB-Kosov%C3%ABs.pdf?\\_\\_cf\\_chl\\_jschl\\_tk\\_\\_=0e7956f07973070812568bf7f703e82745d7eaff-1590760795-0-ARc1XM3xUXFU4nAd9rGtvdrY02Asg2tx-u-9RaBeRR1kXUMPyXVlqE9pwwg-YA7TrXgXOB0Ub7kjN50PT7JtJTFdlPtx3LnxD7GMQHejQe7CwK\\_E1Yc9hKY9Vtx-J56iQewhj5MUHGMCUI5FGYmMrSMhLRy3hHY0c\\_xmFEfjbKXkQY7mL2\\_qrD-M09Cm\\_8i6PRmPCghyeGaLAzpf6Q1aP1pJuIPTkcHAcGozL4fWxJc1i-A5U-e3qY-HP-bSC6wpERL\\_Sug5NMvFTwlksAXOXghIcxjMsVYe6nB\\_KjH88OjS6sBUpF-bx-Ou-vmEXVuP-6HpKmqFyuME0wrfopSrutTynUgkJbJb6w-OsptB7Hu7iqUQV6JXWGIgw-Wo0g4Fo8lpRenFYUEFmUNdkPUh\\_ECac0W4TcOHDEq0KIMuG1P-YyK9yDhh6ls-JOvE-5vxVOfdhrajM2lwgkS6FiKpfr2yhzkoCw](https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/03/Vendimet-e-Mbledhjes-s%C3%AB-15-t%C3%AB-t%C3%AB-Qeveris%C3%AB-s%C3%AB-Republik%C3%ABs-s%C3%AB-Kosov%C3%ABs.pdf?__cf_chl_jschl_tk__=0e7956f07973070812568bf7f703e82745d7eaff-1590760795-0-ARc1XM3xUXFU4nAd9rGtvdrY02Asg2tx-u-9RaBeRR1kXUMPyXVlqE9pwwg-YA7TrXgXOB0Ub7kjN50PT7JtJTFdlPtx3LnxD7GMQHejQe7CwK_E1Yc9hKY9Vtx-J56iQewhj5MUHGMCUI5FGYmMrSMhLRy3hHY0c_xmFEfjbKXkQY7mL2_qrD-M09Cm_8i6PRmPCghyeGaLAzpf6Q1aP1pJuIPTkcHAcGozL4fWxJc1i-A5U-e3qY-HP-bSC6wpERL_Sug5NMvFTwlksAXOXghIcxjMsVYe6nB_KjH88OjS6sBUpF-bx-Ou-vmEXVuP-6HpKmqFyuME0wrfopSrutTynUgkJbJb6w-OsptB7Hu7iqUQV6JXWGIgw-Wo0g4Fo8lpRenFYUEFmUNdkPUh_ECac0W4TcOHDEq0KIMuG1P-YyK9yDhh6ls-JOvE-5vxVOfdhrajM2lwgkS6FiKpfr2yhzkoCw)
- 33 Shih vendimin në: <https://MSh.rks-gov.net/wp-content/uploads/2020/04/Vendim-1.pdf>
- 34 Shih vendimin në: <https://MSh.rks-gov.net/permbledhje-ekzekutive-korniza-e-menaxhimit-social-dhe-mjedisor-per-reagimin-ndaj-covid-19-te-projektit-te-shendetesise-ne-kosove/>

- 35 Shih vendimin në: [https://MSh.rks-gov.net/wp-content/uploads/2020/05/Vendimi-p%C3%ABr-lejimin-e-veprimtaris%C3%AB-t%C3%AB-stoma-tologeve-dhe-fizioterapeut%C3%ABve\\_compressed-1-1.pdf](https://MSh.rks-gov.net/wp-content/uploads/2020/05/Vendimi-p%C3%ABr-lejimin-e-veprimtaris%C3%AB-t%C3%AB-stoma-tologeve-dhe-fizioterapeut%C3%ABve_compressed-1-1.pdf)
- 36 Shih vendimin në: <https://MSh.rks-gov.net/wp-content/uploads/2020/05/Vendimi-p%C3%ABr-fizioterapeut%C3%AB.pdf>
- 37 Shih vendimin në: <https://MSh.rks-gov.net/wp-content/uploads/2020/05/Vendimi-p%C3%ABr-Superlig%C3%ABn-e-Kosov%C3%ABs-n%C3%AB-futboll.pdf>
- 38 Intervistë me Drejtorin e Agjencisë së Punësimit, Drin Haraçia, 21 maj 2020, Prishtinë.
- 39 [https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---europe/---ro-geneva/---sro-budapest/documents/publication/wcms\\_648879.pdf](https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---europe/---ro-geneva/---sro-budapest/documents/publication/wcms_648879.pdf)
- 40 Intervistë përmes email-it me Policinë e Kosovës – Zyra për Informim DPP, 15 maj dhe 19 qershor 2020, Prishtinë.
- 41 Intervistë me z. Afrim Llabjani, Drejtori i Arsimit në Komunën e Ferizajt, 18 maj 2020, Ferizaj.
- 42 Intervistë me z. Bekim Ademi, Koordinator i Shtabit Emergjent në Komunën e Ferizajt, 18 maj 2020, Ferizaj.
- 43 Intervistë me z. Lulzim Qerimi, Nënkyetar për Komunitete në Komunën e Lipjanit, 22 maj 2020, Lipjan.
- 44 Intervistë me z. Ali Topalli, Zyra për Informim – Fushë Kosovë, 19 maj 2020, Fushë Kosovë.
- 45 Intervistë përmes Viber-it me z. Senad Ibishi, Voice of Roma, Ashkali and Egyptians (VoRAE), 15 qershor 2020, Prishtinë.
- 46 Intervistë përmes email-it me z. Denur Paçaku, aktivist për të drejtat e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian, 9 qershor 2020, Prishtinë.
- 47 Intervistë me z. Gazmend Salijevec, European Center for Minority Issues Kosovo (ECMI), 10 qershor 2020, Prishtinë.
- 48 Intervistë përmes telefonit me z. Driton Berisha, Roma Education Fund (REF), 17 qershor 2020, Prishtinë.



- 49 Intervistë përmes telefonit me z. Muhamet Arifi, Ballkan Sunflowers Kosova (BSFK), 26 qershor 2020, Prishtinë.
- 50 Intervistë përmes Viber-it me z. Bajram Kinolli, aktivist për të drejtat e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian, 10 qershor 2020, Prishtinë.
- 51 Intervistë përmes email-it me z. Osman Osmani, BRO “Nevo Koncepti”, 18 qershor 2020, Prishtinë.



Katalogimi në botim - (CIP)  
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

316.342(=214.58:496.51)"2020"(048.8)

Sfidat e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë  
gjatë pandemisë Covid - 19 / ky raport u hartua nga:  
Aulonë Memeti, Durim Jasharaj. - Prishtinë : Admovere, 2020  
. - 52 f.; 21 cm.

1.Memeti, Aulonë 2. Jasharaj, Durim

**ISBN 978-9951-9012-0-8**

ISBN 978-9951-9012-0-8



9 789951 901208

